

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Makina (Fadrome e re)”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Automjete (34100000-8), Automjete te renda (34140000-0)

**VLERA E FONDIT LIMIT: 9,050,000 (nëntë milion e pesëdhjetë mijë) lekë PA TVSH.**

**Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marre 3 (tre) oferta nga operatorët ekonomike qe operojne ne treg dhe duke perlllogaritur vleren mesatare te tyre ne perputhje me parashikimet ligjore te nenit 76, paragrafii pare pika b) ,të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçe** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: **2019, 2020, 2021**, ku vlera e xhiros për

të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40 % vleres te parashikuar te kontrates.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 paragrafi 2 pika b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

*Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se vlera e fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2b te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne:*nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nëzbatimtëLigjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat",I ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5,datë 30.01.2006,"Për tatimin mbi të ardhurat",I ndryshuar,VKM-së Nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore,vetëm nëpërmjet formes elektronike",si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

---

## **2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të

plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

➤ **Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencën e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor (DAP-in).**

*Ne rast se dokumentet e mesiperme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcitua

**Shënim:** Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...*”, sjellim në vëmendje se:

- Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve /pajiseje të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara fazes së nenshkrimit të kontratës duhet t’i dergojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje

të njësuara me origjinalin. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjesve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Termet e referencës, sasitë, specifikimet teknike janë hartuar nga personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr. 201/1 Prot., date 22.02.2023.**

**Ato janë si më poshtë:**

Specifikimi i Materialeve:

<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i mallrave</b>	<b>Sasia</b>	<b>Afati</b>
1	Fadrome	1 cope	25 dite

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

#### **Të përgjithshme.**

- Fadroma do të përdoret kryesisht për pastrimin e rrugëve rurale dhe ngarkimin e materialeve për zhavorrimin e rrugëve në të gjithë territorin e bashkisë dhe njësive administrative.
- Fadroma duhet të jetë plotësisht e montuar me të gjitha pajisjet standarte normale, dhe e gatshme për të filluar punë të menjëhershme.
- Karakteristikat e sigurisë të sistemit të frenimit, drejtimit, ecjes, ndriçimit, dhe të gjitha pajisjet dhe aparaturat duhet të jenë konform rregullave dhe standardeve të Bashkimit Europian

#### **Specifikime teknike kryesore të mjetit :**

- Fadroma duhet të jetë e tipit gjysmëlevizëse me shasi të artikulluar, hidraulik, me goma dhe me kovë ngarkuese përpara dhe mbrapa .

- Mjeti te jete jo me i vjeter se viti 2021
- Peshja e mjetit duhet te jete jo me pak se 8500-8700 kg
- Gjatesia e mjetit jo me pak se 5.6 m
- Lartesia e mjetit jo me pak se 3.6 m
- Gjeresia e mjetit jo me pak se 2.2 m
- Mjeti te jete i ri dhe i pa perdorur me perpara
- Motorri te jete me nafte me ftohje me uje, me fuqi 80kw-85 kw (kilovat)
- Depozita e karburantit jo me e vogel se 140 l
- Cilindrat jo me e vogel se 4.6 cc
- Gabina duhet te jete konform rregullave te Bashkimit Europian, me sistem te ngrohjes dhe ftohjes etj
- Sistemi elektrik me tension 12 V, bateri 120 Amp/ore
- Fadroma duhet te jete e paisur me manualet e operimit dhe servisimit
- Gjendje e pergjithshme optimale e jashtme te jete e rregullt.
- Fadroma duhet te realizoje operimin e njekohshem te koves, kthimin majtas-djathtas te platformes se siperme dhe mekanizmit te levizjes.
  - Kova e perparme te jene me kapacitet rreth 1.1-1.5 m3 (meter kub) dhe gjeresi jo me pak se 2200 mm
  - Kovat e pasme te jene te rrotullueshme me kapacitet jo me te vogel se 0.14 m3 (meter kub) dhe rrotullimi i koves jo me pak se 180°
- Gomat te perparme 12.5/80-18 ose 340 80 18
- Gomat e pasme 16.9-28 ose 440 80 28
- Kunderpesha te jete standarte
- Sistemi i kontrollit te jete manual me 4 pozicione
- Me kondicioner
- Sistem SRS
- Trasmision 4X4
- E paisur me sistemin kundra ndotjes AD BLUE

### **Garancia dhe sherbimi i pas shitjes**

- Fadroma duhet te jete e mbuluar me nje garanci teknike nje vit nga dita e marrjes ne dorezim te mjetit.
- Ofertuesi duhet te konfirmoje nje servis i cili eshte operues ne territorin e Shqiperise duke dhene adresen ose adresat ku mund te kryhen sherbimet e pas shitjes. Ky servis do te jete pergjegjes per mbulimin e sherbimeve gjate periudhes se garancise. Ne rastet kur per riparimin e mjetit lind nevoja qe mjeti te transportohet jashte qytetit, shpenzimit do te mbulohen nga operatori ekonomik.
- Çmimi i fadromes perfshin dhe transportin deri ne objekt.

Ne vleren e kontrates do te perfshihen te gjitha veprimet e kalimit te pronesise te mjetit ne emer te N. Sh. P, perfshire ketu: Leje Qarkullimi, Taksa, Siguracion, Kolaudim.

*Specifikimet e mjetit janë hartuar duke patur parasysh nevojat efektive të Ndermarrjes së Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë për realizimin e punëve dhe sherbimeve publike në interes të komunitetit. Parametrat teknike të parashikuara në këtë procesverbal janë vendosur duke patur si qëllim që mjeti të plotësojë të gjitha kushtet e nevojshme për të kryer funksionet e tij gërmuese, transportuese, ngarkuese, shpërhapëse të inerteve, dherave dhe materialeve të ndërtimit etj. në funksion të realizimit të punëve të ndermarrjes. Viti i prodhimit të mjetit është parashikuar që mjeti të jetë i ri me një normë të ulët konsumi me qëllim që përdorimi i tij të jetë afatgjatë dhe kostot e konsumit të tij të ulëta. Autoriteti kontraktor ka gjykuar që në fondin limit të përfshihen edhe garancia teknike e parashikuar për një periudhë 1 vjeçare nga marrja në dorezim e mjetit përfshirë edhe mirëmbajtja e mjetit në një servis brenda Republikës së Shqipërisë. Këto shpenzime së bashku me shpenzimet për kalimin e të drejtës së pronësisë dhe dokumenteve të mjetit do të përfshihen në vlerën e kontratës.*

Specifikimet teknike janë hartuar pas verifikimeve të kryera në lidhje me nevojat për automjete që ka ndermarrja.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## TERMAT E REFERENCES

Dorezimi i mjetit do të kryhet me shpenzimet e kontraktorit pranë Ndermarrjes së Sherbimeve Publike.

### Afati

Afati i levrimit të mjetit: *25 dite nga data e lidhjes së kontratës*

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Materialet janë kërkuar sipas sasive dhe nevojave efektive për të përbushur nevojat e ndermarrjes në mënyrë të plotë për realizimin e sherbimeve në interes të komunitetit. Materialet janë specifikuar në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për të qenë sa më rezistente dhe të dukshme në rrugë, gjithashtu që do të përbushin të gjitha standartet rrugore.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke*

***argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*